azhbr
AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL | AGJENCIA IPARD

agro pika

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

SKEMA KOMBËTARE E MBËSHTETJES PËR FERMERËT

29 MAJ - 19 QERSHOR

MANUALI I FERMERIT 2020

azhbr
AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL | AGJENCIA IPARD

SKEMA KOMBËTARE E MBËSHTETJES PËR FERMERËT

29 MAJ - 19 QERSHOR

1. TUFA BAZË E MATRIKULLUAR

2. BLETARIA

3. FINANCIME PËR ZËVENDËSIM PLASTMASI TERMIK

4. MBJELLJE BIMËSH MJEKËSORE DHE AROMATIKE

5 & 6. MBËSHTETJE PËR FERMAT ORGANIKE DHE CERTIFIKIMIN GLOBAL GAP

7. INVESTO NË AGROTURIZËM DHE PËRFITO 50% FINANCIM

azhbr.gov.al

MASA 1: **TUFA BAZË E MATRIKULLUAR**

AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL shpall thirrjen për aplikime nga fondet mbështetëse për bujqësinë dhe zhvillimin rural

I. Për rritjen e konkurrueshmërisë së prodhimeve blegtorale nëpërmjet pagesave të kafshëve të matrikulluara

- Mbështetje për **tufën bazë të matrikulluar** (kafshët riprodhuese) për fermat me **jo me pak se 70 krerë dele dhe/ose dhi** në vlerën **1.200 lekë për krerë**, jo më shumë se 360.000 lekë për subjekt.
- Mbështetje në vlerën 10.000 lekë për krerë për fermat **jo më pak se 5 krerë lopë**, jo më shumë se 500.000 lekë për subjekt.

0 dokumenta **e-Albania**

- **Përfituesit e mundshëm:** Fermerë individual, persona fizik ose juridik, Shoqëritë e Bashkëpunimit Bujqësor
- **Aplikanti me status fermer, person fizik ose juridik** duhet të ketë NIPT aktiv.
- Kafshët e tufës bazë **duhet të jenë të regjistruara** në sistemin e identifikimit dhe regjistrimit të kafshëve RUDA.
- Aplikanti **mund të aplikojë për masën mbështetëse nr. 1**, dhe të përfitojë për të tre speciet e kafshëve.
- Për **aplikimet që janë mbi vijën e financimit**, në rasti se aplikanti rezulton debitor ndaj MBZHR, AZHBR dhe Tatimeve apo nuk ka shlyer detyrimet sigurimet shoqërore, duhet të dorëzojë dokumentin që vërteton shlyerjen e detyrimeve **brenda datës 17 korrik 2020.**

Afati përfundimtar i dorëzimit të dokumentacionit të specifikuar në listën e aplikimeve të kualifikuara mbi vijën e financimit në faqen zyrtare: **www.azhbr.gov.al** është data **17 korrik 2020.**

APLIKIMET PRANOHEN NGA DATA 29.05.2020 DERI MË 19.06.2020

- Nuk kërkohen dokumenta shtesë për të dhënat e gjeneruara nga portali e-Albania dhe të konfirmuara në formularin online.
- Aplikimet on-line bëhen nga vetë aplikanti përmes portalit e-Albania.

MASA 2: **BLETARIA**

AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL shpall thirrrjen për aplikime nga fondet mbështetëse për bujqësinë dhe zhvillimin rural

- Mbështetje për mbarështimin e bletarisë me **1.000 lekë për koshere** për fermat me **jo më pak se 50 zgjoje**, por jo më shumë se 150.000 lekë për subjekt.

0 dokumenta **e-Albania**

- **Përfituesit e mundshëm:** Fermerë individual, person fizik ose juridik, Shoqëritë e Bashkëpunimit Bujqësor
- **Aplikanti me status fermer, person fizik ose juridik** duhet të ketë NIPT aktiv.
- **Kosheret e bletëve të jenë të matrikulluara dhe të regjistruara** në regjistrin elektronik të ARSHVMB sipas rajoneve
- Për **aplikimet që janë mbi vijën e financimit**, në rasti se aplikanti rezulton debitor ndaj MBZHR, AZHBR dhe Tatimeve apo nuk ka shlyer detyrimet sigurimet shoqërore, duhet të dorëzojë dokumentin që vërteton shlyerjen e detyrimeve **brenda datës 17 korrik 2020.**

Afati përfundimtar i dorëzimit të dokumentacionit të specifikuar në listën e aplikimeve të kualifikuara mbi vijën e financimit në faqen zyrtare: **www.azhbr.gov.al** është data **17 korrik 2020.**

APLIKIMET PRANOHEN NGA DATA 29.05.2020 DERI MË 19.06.2020

- Nuk kërkohen dokumenta shtesë për të dhënat e gjeneruara nga portali e-Albania dhe të konfirmuara në formularin online.
- Aplikimet on-line bëhen nga vetë aplikanti përmes portalit e-Albania.

MASA 3: **FINANCIME PËR ZËVENDËSIM PLASTMASI TERMIK**

AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL shpall thirrjen për aplikime nga fondet mbështetëse për bujqësinë dhe zhvillimin rural

II. Mbështetje për rritjen e konkurrueshmërisë për prodhimet bujqësore në mjedise të mbrojtura dhe uljen e kostove të prodhimit

- **Mbështetje për zëvendësimin e plastmasit termik** për serrat diellore ekzistuese për prodhimin e perimeve **në vlerën 300.000 lekë për ha, rrushit për tavolinë dhe tunelet plastike për prodhimin e luleshtrydhes në vlerën 100.000 lekë për ha**, por jo më shumë se 500.000 lekë për subjekt.
- Sipërfaqja e serrës ose tunelit plastik për prodhimin e luleshtrydhes të jetë **jo më pak se 0.2 ha.**

0 dokumenta **e-Albania**

- **Përfituesit e mundshëm:** Fermerë individual, person fizik ose juridik
- **Aplikanti me status fermer, person fizik ose juridik** duhet të ketë NIPT aktiv. Përfitojnë financime aplikantët që gjatë 3 viteve të fundit nuk kanë përfituar për zëvendësim plastmasi për të njëjtën serrë apo tunel prodhimi
- **Plastmasi të jetë termik i tipit "long life", vërtetuar me certifikatën e garancisë**
- **Aplikanti duhet të ketë tokën në pronësi, dhe/ose me qera për të paktën 5 vjet, duke përfshirë dhe vitin e aplikimit.**
- Për **aplikimet që janë mbi vijën e financimit**, në rasti se aplikanti rezulton debitor ndaj MBZHR, AZHBR dhe Tatimeve apo nuk ka shlyer detyrimet sigurimet shoqërore, duhet të dorëzojë dokumentin që vërteton shlyerjen e detyrimeve **brenda datës 17 korrik 2020.**

Afati përfundimtar i dorëzimit të dokumentacionit të specifikuar në listën e aplikimeve të kualifikuara mbi vijën e financimit në faqen zyrtare: **www.azhbr.gov.al** është data **17 korrik 2020.**

APLIKIMET PRANOHEN NGA DATA 29.05.2020 DERI MË 19.06.2020

- Nuk kërkohen dokumenta shtesë për të dhënat e gjeneruara nga portali e-Albania dhe të konfirmuara në formularin online.
- Aplikimet on-line nga vetë aplikanti përmes portalit e-Albania.
- Përfitues janë subjektet, të cilat nuk mund të mbështeten nga programi IPARD II.

MASA 4: **MBJELLJE BIMËSH MJEKËSORE DHE AROMATIKE**

AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL shpall thirrrjen për aplikime nga fondet mbështetëse për bujqësinë dhe zhvillimin rural

- Për shtimin e **sipërfaqeve të mbjella me bimë mjekësore dhe aromatike në vlerën 200.000 lekë për ha**, por jo më shumë se **1.000.000 lekë për fermerët individualë dhe për grup fermerësh**. Ndërsa për Shoqëritë e Bashkëpunimit Bujqësor vlera e përfitimit financiar është **jo më shumë se 4.000.000 lekë.**

0 dokumenta e-Albania

- **Përfituesit e mundshëm:** Fermerë individualë, grup fermerësh, person fizik ose juridik, Shoqëritë e Bashkëpunimit Bujqësor
- Sipërfaqja e mbjellë për fermerët individualë duhet të jetë **jo më pak se 0.2 ha**.
  Për grup fermerësh jo më pak se 1 ha në një bllok të vetëm, për SHBB jo më pak se 5 ha.
  Madhësia e ngastrës të jetë jo më pak se 0.2 ha, në rastin kur nuk është në bllok.
- **Materiali mbjellës bimor të jetë i certifikuar dhe i regjistruar** në Katalogun Kombëtar të Specieve dhe Varieteteve dhe të realizojë mbjelljet brenda 6-mujorit të parë të vitit 2020.
- **Faturat e blerjes së materialit mbjellës duhet të përputhen me periudhën e mbjelljeve.**
- **Aplikanti duhet të ketë tokën në pronësi, dhe/ose me qera për të paktën 5 vjet, duke përfshirë dhe vitin e aplikimit.**
- Për **aplikimet që janë mbi vijën e financimit**, në rasti se aplikanti rezulton debitor ndaj MBZHR, AZHBR dhe Tatimeve apo nuk ka shlyer detyrimet sigurimet shoqërore, duhet të dorëzojë dokumentin që vërteton shlyerjen e detyrimeve **brenda datës 17 korrik 2020.**

Afati përfundimtar i dorëzimit të dokumentacionit të specifikuar në listën e aplikimeve të kualifikuara mbi vijën e financimit në faqen zyrtare: **www.azhbr.gov.al** është data **17 korrik 2020.**

APLIKIMET PRANOHEN NGA DATA 29.05.2020 DERI MË 19.06.2020

- Nuk kërkohen dokumenta shtesë për të dhënat e gjeneruara nga portali e-Albania dhe të konfirmuara në formularin online.
- Aplikimet on-line bëhen nga vetë aplikanti përmes portalit e-Albania.

MASA 5&6: **MBËSHTETJE PËR FERMAT ORGANIKE DHE CERTIFIKIMIN GLOBAL GAP**

AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL shpall thirrjen për aplikime nga fondet mbështetëse për bujqësinë dhe zhvillimin rural

III. Mbështetje për fermat organike, për periudhën në kalim, vitin e parë në vlerën 100.000 lekë, në vitin e dytë 150.000 lekë, dhe 200.000 lekë për fermë të certifikuar.

- **Zbatimi dhe certifikimi GLOBAL GAP** për perime, fruta, rrush, ullinj dhe agrume në masën 50% të vlerës totale të faturës tatimore, me vlerë financimi **jo më shumë se 175.000 lekë, për sipërfaqe jo më pak se 1 ha.**

0 dokumenta **e-Albania**

- **Përfituesit e mundshëm:** Fermerë individualë, grup fermerësh, person fizik ose juridik, Shoqëritë e Bashkëpunimit Bujqësor
- **Përfitojnë të gjithë aplikuesit që janë në sistem certifikimi** në kalim (viti i parë dhe/ose viti i dytë) ose në certifikim me kushtin që **sipërfaqja e mbjellë që certifikohet të mos jetë më e vogël se 0.5 ha.**
- **Në rastin e certifikimit GLOBAL GAP**, aplikanti mund të përfitojë një certifikatë që mund të përmbajë më shumë se një produkt, në sipërfaqe jo më pak se 1 ha, për një ose më shumë kulturë të mbjella.
- Certifikata të ketë elementë të verifikueshëm on-line për operatorin, trupën e certifikimit dhe organizmin akreditues në faqen zyrtare GLOBAL GAP.
- **Aplikanti duhet të ketë tokën në pronësi, dhe/ose me qera për të paktën 5 vjet, duke përfshirë dhe vitin e aplikimit.**
- Për **aplikimet që janë mbi vijën e financimit**, në rasti se aplikanti rezulton debitor ndaj MBZHR, AZHBR dhe Tatimeve apo nuk ka shlyer detyrimet sigurimet shoqërore, duhet të dorëzojë dokumentin që vërteton shlyerjen e detyrimeve **brenda datës 17 korrik 2020.**

Afati përfundimtar i dorëzimit të dokumentacionit të specifikuar në listën e aplikimeve të kualifikuara mbi vijën e financimit në faqen zyrtare: **www.azhbr.gov.al** është data **17 korrik 2020.**

APLIKIMET PRANOHEN NGA DATA 29.05.2020 DERI MË 19.06.2020

- Nuk kërkohen dokumenta shtesë për të dhënat e gjeneruara nga portali e-Albania dhe të konfirmuara në formularin online.
- Aplikimet on-line bëhen nga vetë aplikanti përmes portalit e-Albania.

MASA 7: **INVESTO NË AGROTURIZËM DHE PËRFITO 50% FINANCIM**

AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL shpall thirrrjen për aplikime nga fondet mbështetëse për bujqësinë dhe zhvillimin rural

IV. MBËSHTETJA E DIVERSIFIKIMIT TË AKTIVITETEVE EKONOMIKE NË ZONAT RURALE

- Mbështetje për ngritjen ose rikonstruksionin e ambienteve për veprimtari **të turizmit rural** nga **6 deri në 10 dhoma**, në 50% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se **5.000.000 lekë** për subjekt.

- **Përfituesit e mundshëm** janë subjektet me status fizik, juridik ose SHBB të regjistruar në QKB për aktivitetin që aplikojnë.
- **Investimet e pranueshme janë në zonat rurale. Subjektet duhet** të aplikojnë me plan biznezi 5-vjecar, sipas modelit zyrtar të publikuar në faqen zyrtare të AZHBR: www.azhbr.gov.al
- **Investimi nuk duhet të fillojë para lidhjes së kontratës.** Leja e ndërtimit /rikonstruksionit të sigurohet para lidhjes së kontratës, por jo më vonë se 60 ditë pune nga data e përfundimit të aplikimeve.
- **Përfitues janë subjektet,** të cilat nuk mund të mbështeten nga programi IPARD II.

ⓘ APLIKIMET PRANOHEN NGA DATA 29.05.2020 DERI MË 19.06.2020

Dokumentacioni që dorëzohet:

1. Formular aplikimi standard
2. Fotokopje e kartës së identitetit/pasaportës biometrike së aplikantit apo përfaqësuesit ligjor, fotokopje e NIPT-it.
3. Aplikanti duhet të ketë dokumentin e pronësisë/qiramarrjes së tokës/ndërtesë lëshuar nga DVASHK, shoqëruar me kartelë pasurie të rifreskuar dhe lëshuar jo më shumë se 30 ditë nga data e aplikimit. Ndërtesa/toka që do të përdoret për investimin të jetë në pronësi, ose e marrë më qera për një periudhë mbi 9 vjet, nga momenti i aplikimit, në emër të aplikantit/subjektit aplikues.
4. 3 oferta origjinale me datë, firmë dhe vulë, të shoqëruara me formularin e regjistrimit të QKB të subjekteve ofertuese
5. Dokumentat specifike të tjera të detajuara për këtë masë mbështetëse në faqen zyrtare të AZHBR: **www.azhbr.gov.al**

azhbr
AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL | AGJENCIA IPARD

Aplikimet për këtë masë mbështetëse dorëzohen në AZHBR qendër në adresën: Rruga “Muhamet Gjollesha”, nr.56, Tiranë.

Dokumentacioni i dorëzuar firmoset/vuloset dhe dorëzohet me zarf të mbyllur, ku shkruhet masa e mbështetjes, emri i aplikantit/subjektit dhe adresa postare e tij.

azhbr.gov.al

APLIKO NË SKEMËN KOMBËTARE TË MBËSHTETJES PËR FERMERËT

APLIKIMET VETEM ONLINE e-Albania

29 MAJ - 19 QERSHOR

azhbr AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQESOR DHE RURAL | AGJENCIA IPARD

agropika

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

0 dokumenta **e-albania** **Agropika**

Telefono falas **08008383**

Informacionin për mënyrën e aplikimit e gjeni edhe në faqen e internetit azhbr.gov.al